

Organizimi i Shërbimit Kombëtar të Urgjencës Mjekësore :

1. Shërbimi i urgjencës mjekësore është pjesë përbërëse e sistemit të kujdesit shëndetësor, i cili ofrohet pandërprerë për 24 orë, në të gjithë nivelet e ofrimit të kujdesit shëndetësor.
2. Shërbimi i urgjencës mjekësore organizohet dhe ofrohet në nivel:
 - a) parësor
 - b) spitalor
 - c) spitalor universitar
 - ç) spitalor universitar i traumës.
3. Në të gjitha nivelet e shërbimit të urgjencës mjekësore ofrohet shërbim me standarde të miratuara me urdhër të Ministrit përgjegjës për shëndetësinë. Këto standarte përcaktojnë infrastrukturën fizike, barnat dhe pajisjet mjekësore, mallra dhe materiale të ndryshme, si dhe burimet njerezore të nevojshme për ofrimin e këtij shërbimi.
4. Të gjitha shërbimet e urgjencës mjekësore në strukturat shtetërore dhe private raportojnë periodikisht, pranë Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, bazuar në kërkesat e Regjistrimit Kombëtar të Urgjencës Mjekësore, sipas VKM 735, datë 20.10.2016.

Detyrat dhe Funkcionet e Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore

1. QKUM koordinon shërbimin cilësor, në kujdesin parësor, spitalor, trajtimin dhe transportin me autoambulancë për në urgjencën spitalore.
2. Koordinon dhe monitoron ndihmën e parë për cdo person në kushtet e urgjencës mjekësore, duke filluar nga vendi i ngjarjes.
3. Siguron kujdesin mjekësor të specializuar për cdo person në kushtet e urgjencës mjekësore.
4. Siguron ndihmën e parë dhe kujdesin mjekësor të specializuar në raste të emergjencave shëndetësore dhe civile, nëpërmjet sistemit të koordinimit, pranë Njësisë së Koordinimit të Urgjencave Mjekësore në QKUM.
5. Siguron transportin tokësor, ajror dhe ujor të përshtatshëm për shpëtimin e jetes, ofrimin e kujdesit shëndetësor në kushtet e urgjencës mjekësore dhe transferimin në strukturat e specializuara.

